



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 465 prot.

Pukë, më 17.03. 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 6 datë 17.03.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

Z. KADRI MORINA

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë _____.03.2026;

Vendosi:

1. T'i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. KADRI MORINA

Me motivacionin:

“Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për kontributin e çmuar në mbështetje të zhvillimit dhe mirëqenies së komunitetit. Përmes financimeve dhe donacioneve të vazhdueshme ka realizuar objektiva dhe iniciativave me interes kulturor dhe publik, lidhur me promovimin dhe kultivimin e vlerave përmes solidaritetit dhe humanizmit, veçanërisht në ndihmë të shtresave në nevojë; si dhe për lidhjen e veçantë dhe miqësinë e dëshmuar ndër vite me qytetin dhe komunitetin e Pukës.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

Paraqitën projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 465/1 prot.

Pukë, më 17.03. 2026

RELACION

**PËR PROJEKTVENDIMIN "PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' TË
BASHKISË PUKË, Z. KADRI MORINA"**

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Pukë,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, konkretisht nenit 9, pika 1.7 dhe nenit 54, germa "m", të ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", si dhe të VKM nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", paraqitet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Bashkisë Pukë projektvendimi për dhënien e titullit "Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë" për z. Kadri Morina.

Gjithashtu, projektvendimi mbështetet në VKB nr. 71, datë 27.12.2024, "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor për titujt vendorë të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre".

Dhënia e titujve vendorë të nderit përbën një akt të rëndësishëm institucional, përmes të cilit vlerësohen dhe nderohen individë që kanë dhënë kontribute të veçanta në zhvillimin e shoqërisë, në shërbim të interesit publik dhe në promovimin e vlerave më të mira njerëzore e qytetare.

Në këtë kuadër, figura e z. Kadri Morina, President i grupit financiar EUROSIG, INSIG dhe UBA BANK, përfaqëson një personalitet të spikatur në fushën e sipërmarrjes dhe financave, si dhe një kontribuues i vazhdueshëm në mbështetje të komuniteteve dhe zhvillimit social.

Përmes angazhimit të tij të qëndrueshëm dhe vizionit të qartë në drejtimin e institucioneve financiare që përfaqëson, ai ka dhënë një kontribut të çmuar në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies së komunitetit, duke financuar dhe mbështetur iniciativa të ndryshme me interes publik.

Veçanërisht i vlerësueshëm është roli i tij në realizimin e projekteve dhe objekteve që i shërbejnë drejtpërdrejt qytetarëve, si dhe në mbështetjen e vazhdueshme përmes donacioneve dhe ndihmës konkrete ndaj shtresave në nevojë.

Kontributi i z. Kadri Morina shtrihet gjithashtu në promovimin dhe kultivimin e vlerave të solidaritetit dhe humanizmit, duke dëshmuar një ndjeshmëri të veçantë ndaj problematikave sociale dhe duke qenë pranë komunitetit në momente të rëndësishme.

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së tij është edhe ndihja e veçantë që ka dhënë në këto vite me qytetin dhe komunitetin e Pukës, duke mbështetur iniciativa lokale dhe duke kontribuar në forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe zhvillimit.

Propozimi për dhënien e këtij titulli është shqyrtuar nga Komisioni Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Bashkinë Pukë, i cili, në përputhje me rregulloren përkatëse, ka dhënë miratimin për vijimin e procedurës.

Në këtë kuadër, dhënia e titullit “Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë” për z. Kadri Morina përbën një akt të merituar mirënjohjeje dhe respekti institucional për kontributin e tij të çmuar në zhvillimin e komunitetit, për angazhimin humanitar dhe për promovimin e vlerave më të mira shoqërore.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli i Bashkisë Pukë të shqyrtojë dhe të miratojë projektvendimin “Për dhënien e titullit ‘Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë’ për z. Kadri Morina”.

Bashkëlidhur:

1. PROJEKT VENDIMI, Nr. 06, datë 17.03.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ I BASHKISË PUKË Z.KADRI MORINA

2. Miratimi i Komisionit Këshillimor.

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SOKOL GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KOMISIONI KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT VENDOR TË NDERIT

Nr. _____ prot.

Pukë, më ____ . ____ . 2026

MIRATIM

PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ I BASHKISË PUKË

Z. KADRI MORINA

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, si dhe VKB nr.70, datë 27.12.2024, “Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë”; pasi u njohëm me materialet dhe dosjen e plotë, përmes së cilës dokumentohet roli i Z. Kadri Morina, si një biznesmen i suksesshëm dhe mbështetës i përkushtuar i projekteve me ndikim social, ka kontribuar në forcimin e frymës së bashkëpunimit dhe solidaritetit në shoqëri, duke u bërë një shembull i përgjegjësishë qytetare dhe i përkushtimit ndaj komunitetit.shprehemi unanimisht për vlerësimin e tij të merituar nga Bashkia Pukë si “Qytetar Nderi”,

KOMISIONI KËSHILLIMOR

1. Sokol Gjoni _____

2. Denisa Meçi _____

3. Endrit Kraja _____

4. Rasim Laçi _____

5. Ylli Hadroj _____